



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.4/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Rrustem Thaçi dhe Adnan Konushevci anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjore Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), paraqitur kundër subjektit politik, Lista Serbe, për shkak të vendosjes së pllakatave të subjektit politik në shtylla elektrike dhe në rrugë publike për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunitet: Mitrovica e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan, në seancën e panelit të mbajtur me 20.05.2019, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), dhe subjektit politik Lista Serbe, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 2100.00 (dymijë e njëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Me datën 17.05.2019, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) me të cilën pretendohet se me datën 16.05.2019, në rrugën Knjaz Millosha dhe Krala Petra në pjesën e qendrës së qytetit të Mitrovicës së Veriut gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore për zgjedhjet lokale të këtyre komunave, kanë vrejtur dhe kanë hasur pllakata me emër të subjektit politik Lista Serbe, të ngjitur në hapësira publike dhe atë në shtyllat elektrike.

Parashtruesi i ankesës thekson se me këtë është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 33 paragrafi 1 pika b) i LZP-së Ligji Nr.03/L-073

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur një fotografi të printuar.

PZAP-i, në kuptim të nenit 7 paragrafi 1 i Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it Nr.02/2015, me datë 17.05.2019, njoftoi subjektin politik Lista Serbe për ankesën e parashtruar, dhe ka kërkuar që të përgjigjet deri me datë 18.05.2019, në ora 16:00, mirëpo subjekti politik në fjalë nuk ofroi ndonjë përgjigje lidhur me këtë.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografia e ofruar si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se pllakatat e kandidatit për kryetar të komunës së Mitrovicës së Veriut Goran Rakiq nga subjektit politik Lista Serbe, janë vendosur në shtylla elektrike dhe në rrugë publike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton “Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugë publike”

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë, Paneli konstaton se nga ana e subjektit politik Lista Serbe është shkelur neni 33 pika (b) të LZP-së, pasi që pllakatat në emër të subjektit politik Lista Serbe dhe të kandidatit të saj për kryetar të Mitrovicës së Veriut, janë vendosur në vendin i cili nuk është i dedikuar për vendosjen e posterave dhe pllakatave të ndryshme.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjekti politik Lista Serbe, ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe është njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe se përkundër këtij fakti pllakatat në emër të subjektit politik Lista Serbe dhe kandidatit të saj, janë të vendosura në shtyllat elektrike pra në rrugë publike. Poashtu Paneli si rrethanë mori edhe faktin se subjektit politik Lista Serbe ia dha mundësinë për tu përgjigjur në ankesë, por subjekti politik në fjalë nuk ofroi ndojë përgjigje me të cilën do të dëshmonte se ka ndërmarrar ndonjë veprim për të bërë përmisimin e shkeljes, e i cili veprim ka ndikuar në lartësin e gjobës së shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.4/2019 më datën 20.05.2019.



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.